



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 maj 2015
Nr. ref.: VTK 797/15

VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA

në

Rastin nr. KI178/14

Parashtrues

Xufe Racaj

**Kërkesë për përmirësimin e Aktvendimit për papranueshmëri
të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në
Rastin KI107/14, të 26 nëntorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI178/14 është dorëzuar nga znj. Xufe Racaj, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Në kërkesën KI178/14, parashtruesja e kërkesës i referohet Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) në Rastin nr. KI107/14, të 26 nëntorit 2014, i cili i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 27 nëntor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës KI178/14 është kërkesa për përmirësimin dhe rishqyrtimin eventual pasues të Aktvendimit për papranueshmëri nr. KI107/14, të 26 nëntorit 2014.

Baza juridike

4. Kërkesa KI178/14 është vazhdim i kërkesës KI107/14, e cila ishte bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).
5. Kërkesa KI178/14 në mënyrë të posaçme duhet të shihet si e bazuar në rregullin 61 (Përmirësimi i aktgjykimeve dhe i vendimeve) të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 dhjetor 2014, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 12 shkurt 2015, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës KI178/14.
9. Më 15 prill 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës ta heqë kërkesën nga lista.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 23 qershor 2014, parashtruesja e dorëzoi në Gjykatë kërkesën KI107/14 në gjuhën shqipe, duke pretenduar shkelje të "neneve 5 dhe 6 të Konventës". Referenca në nenin 5 dhe 6 të Konventës është përkthyer në gjuhën angleze si pretendim për shkelje të "neneve 5 dhe 6 të Kushtetutës". Versioni në gjuhën angleze ishte baza origjinale e punës për Aktvendimin e 26 nëntorit 2014, në Rastin nr. KI107/14.
11. Paragrafi 4, i atij aktvendimi thotë "*objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës, të garantuara me "nenin 6 (. ..) dhe nenin 5 të Kushtetutës".*

12. Megjithatë, në arsyetimin e aktvendimit të lartpërmendur (në paragrafin 24), Gjykata vërejtë se *“parashtruesja e kërkesës, duke arsyetuar kërkesën e saj, pretendon shkelje të neneve 5 dhe 6 të Kushtetutës. Këto nene kanë të bëjnë me gjuhët dhe simbolet e Republikës së Kosovës dhe asgjë me faktet e kërkesës”*.
13. Në ndërkohë, Gjykata konsideroi se (në paragrafin 25), *“Objekti i çështjes ka të bëjë me shkeljen e së drejtës së parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë”* prandaj vendosi në bazë të nenit 5 dhe 6 të Konventës.
14. Gjykata më tej vlerësoi (në paragrafin 26) se *“parashtruesja e kërkesës nuk ka shpjeguar dhe nuk ka treguar si dhe pse pretendohet të jenë shkelur të drejtat e saj [...] për gjykim të drejtë [...]”*.
15. Përfundimisht, Gjykata konkludoi (në paragrafin 29) se *“në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës, Gjykata konsideron se kërkesa është qartazi e pabazuar”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Në kërkesën KI178/14, parashtruesja e kërkesës pretendon se *“nga Gjykata Kushtetuese ka kërkuar zbatimin e n. 5 dhe 6 të Konventës (e jo të Kushtetutës së R.K.-së), ndërsa Gjykata Kushtetuese e Kosovës në lajthim (error in materiae) ka bazuar Aktvendimin nr. KI107/14 të 25.11.2014 në n. 5 & 6 të Kushtetutës”*.
17. Parashtruesja e kërkesës kërkon që nëpërmjet kërkesës KI178/14 *“të rishikohet Aktvendimi KI107/14 – dt. 7.11.2014 i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, gabimisht (...) është bazuar në nenet inadekuete (5 & 6) të Kushtetutës në vend të po atyre neneve por të Konventës”*.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili parasheh:

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

19. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 32 (4) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest.

20. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 61 (Përmirësimi i aktgjykimeve dhe i vendimeve), i cili parasheh:

(1) Gjykata, ex officio, ose pas kërkesës nga pala, e cila bëhet brenda dy javësh nga dërgimi i aktgjykimit apo i vendimit, mund ta korrigjojë ndonjë gabim teknik ose numerik që është bërë në aktgjykim ose në vendim.

21. Gjykata rikujton se parashtruesja bazon kërkesën e saj KI178/14 në një gabim të pretenduar teknik të Gjykatës.
22. Në të vërtetë, parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata në Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin nr. KI107/14, të 26 nëntorit 2014, i është referuar *“nenit 6 (...) dhe nenit 5 të Kushtetutës”* në vend të *“nenit 6 (...) dhe 5 të Konventës”*.
23. Megjithatë, në Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin nr. KI107/14, Gjykata vlerësoi dhe vendosi për kërkesën në bazë të neneve 5 dhe 6 të Konventës, siç ishte pretenduar fillimisht nga parashtruesja e kërkesës. Pra, nuk ka gabim që duhet të korrigjohet, sepse ai tanimë ishte korrigjuar në aktvendimin e nxjerrë.
24. Përveç kësaj, Gjykata vëren se në kërkesën KI178/14 nuk paraqitet ndonjë pretendim ose dëshmi e re për shkelje të pretenduar nga parashtruesja e kërkesës në Rastin KI107/14; në të vërtetë, parashtruesja ka dorëzuar vetëm një kërkesë për përmirësimin e Aktvendimit për papranueshmëri.
25. Prandaj, Gjykata vlerëson se të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës ishin adresuar dhe arsyetuar plotësisht në Rastin KI107/14, siç ishte kërkuar nga parashtruesja e kërkesës, dhe gabimi i pretenduar ishte përmirësuar në vendimin e mëparshëm të Gjykatës.
26. Gjykata, më tej, konsideron se aktvendimi i nxjerrë në Rastin KI107/14 është përfundimtar dhe detyrues dhe korrigjimi i pretenduar nuk ka ndikim në vendimin e mëparshëm.
27. Prandaj, Gjykata konkludon se nuk ka rast apo kontest në pritje lidhur me çështjen e mësipërme dhe, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës, rregullat 32 (4) dhe 61 (1) të Rregullores së punës, “kërkesa” duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër dhe të hiqet nga lista.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, më 25 maj 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEQË kërkesën nga lista;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani